



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1065/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr1065/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 2709B/01R

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë në të cilën dyshon se nuk është bere sakte numërimi i i votave te mia ne një vendvotim prandaj kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet 2709B/01R, ku un duhet te kem pasur se paku 7 vota ne rezultatet përfundimtare kame vetëm 5 vota si provë kame bashkangjitur kopjet e letërnjoftimit te personave-miqve qe me kane votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Shkëlzen Osmani nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin 2709B/01R, për shkak se dyshon se nuk është bere saktë numërimi i votave ne këtë qendër, si dëshmi ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit te personave qe e kane votuar por jo edhe deklaratën e tyre.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1065/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.